| RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | |
|---|---|
| **EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS** | Projektligj "*Për lirimin e frekuencave të Digjiital Divident dy (DD2)*" |
| **MINISTRIA UDHËHEQËSE** | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; |
| **FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT** | Finale |
| **BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS** | I brendshëm |
| **DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së** | Jo e zbatueshme |
| **PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA** | VKM nr. 636 datë 29.7.2020 "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit";<br>VKM nr. 88 datë 22.2.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030"<br>Dokumenti i pozicionit negociues per Grupkapitullin e trete, per Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media":<br>https://enlargement.ec.europa.eu/news/accession-conference-albania-eu-opens-negotiations-competitiveness-and-inclusive-growth-cluster-2025-05-22_en |
| **DATA E KONSULTIMIT PUBLIK** | 11.09.2025 -09.10.2025 |
| **DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT** | 10.11.2026 |
| **A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?<br>NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT** | Po,<br>16.09.2025 |
| **NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT** | 2025 - MIE - NR.5 |
| **TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)** | Anisa Gjondedaj<br>Anisa.gjondedaj@infrastruktura.gov.al<br>Mario Mazniku<br>mario.mazniku@infrastruktura.gov.al<br>0672000795 |
| | |
| **PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE<br>(Maksimumi 2 faqe)** | |
| PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT<br>*Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij. Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?* | |

Frekuencat janë një burim natyror i kufizuar dhe pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore. Përdorimi i frekuencave rregullohet në nivel global, përmes Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), në nivel rajonal dhe atë kombëtar me qëllim shfrytëzimi eficent, pa interferenca (ndërhyrje).

Problemi kryesor konsiston në moslirimin e brezit të frekuencave 700 MHz (Digital Dividend 2 – DD2) nga transmetimet televizive numerike tokësore dhe, për rrjedhojë, në pamundësinë e vënies së tij në dispozicion për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike mobile broadband (5G). Kjo situatë pengon përmbushjen e afateve të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave dhe angazhimeve në kuadër të integrimit evropian, si dhe vijon të shkaktojë interferenca ndërkufitare me vendet fqinje që e kanë alokuar këtë brez për shërbimet 5G. Pavarësisht përgatitjes së strategjisë dhe planit teknik të migrimit, procesi nuk ka avancuar për shkak të mungesës së një mekanizmi ligjor dhe financiar për adresimin e kostove të rikonfigurimit të rrjeteve dhe kompensimin e pjesshëm të operatorëve të prekur.

**Shkaqet e problemit**

Shkaqet kryesore të problemit lidhen me mungesën e një kuadri të posaçëm ligjor që të parashikojë mekanizmin dhe burimet financiare për kompensimin e pjesshëm të kostove të migrimit të operatorëve të prekur, pasi ligji nr. 97/2013 nuk përmban dispozita të posaçme për adresimin e këtyre efekteve financiare. Një tjetër shkak lidhet me ekzistencën e licencave dhe investimeve të kryera nga operatorët në rrjetet aktuale të transmetimit, të cilat kërkojnë rikonfigurim, përshtatje ose zëvendësim të pajisjeve për lirimin e brezit. Procesi vështirësohet gjithashtu nga kufizimet teknike në disponueshmërinë e frekuencave alternative, nevoja për rikonfigurimin e rrjeteve dhe alotmenteve, si dhe kompleksiteti i koordinimit ndërkufitar për zgjidhjen e interferencave me vendet fqinje.

**Grupet e prekura**

Problematika prek drejtpërdrejt operatorët e transmetimeve televizive numerike tokësore, përfshirë RTSH-në dhe operatorët privatë (Klan TV, Top Channel, Digitalb, Vizion Plus dhe ADTN), të cilët përballen me kostot dhe nevojën për përshtatjen e rrjeteve të tyre të transmetimit, si dhe me pasigurinë lidhur me kompensimin financiar. Publiku (qytetarët), si përdorues përfundimtarë të shërbimeve audiovizive, mund të ndikohet nga ndërprerjet ose degradimi i sinjalit televiziv dhe vështirësitë në aksesin e pandërprerë në shërbimet mediatike. Gjithashtu, preken AMA dhe AKEP, në ushtrimin e funksioneve të tyre rregullatore, mbikëqyrëse dhe administruese të spektrit të frekuencave; Qeveria dhe institucionet përgjegjëse, veçanërisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave, për shkak të përgjegjësisë për krijimin e kuadrit ligjor dhe financiar dhe përmbushjen e angazhimeve evropiane; si dhe vendet fqinje (Italia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia), për shkak të interferencave ndërkufitare që lidhen me përdorimin aktual të këtij brezi.

**OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit*

Ojektivat e synuar nëpërmjet kësaj politike janë:

a) Eliminimi i interferencave ndërkufitare në brezin 700 MHz, në koordinim me administratat përkatëse të frekuencave të Italisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Greqisë dhe Kroacisë, brenda një afati të përcaktuar pas lirimit të brezit.);

b) Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve audiovizive përmes rrjeteve numerike tokësore gjatë dhe pas procesit të migrimit, duke siguruar që të gjithë operatorët e prekur të kryejnë rikonfigurimin e rrjeteve dhe të ruajnë mbulimin e shërbimit sipas parametrave përkatës.;

c) Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga kuadri i BE-së për lirimin dhe riplanifikimin e brezit 700 MHz, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet përkatëse të BE-së dhe dokumentet kombëtare të planifikimit të frekuencave..

d) Mundësimi i përdorimit të brezit 700 MHz për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të gjeneratës së pestë (5G), nëpërmjet përfundimit të procesit të riplanifikimit dhe licencimit të frekuencave përkatëse brenda vitit 2027, me synim zgjerimin e mbulimit me rrjete 5G në nivel kombëtar.;

**Objektivat specifike:**

a) Ulja në nivelin 100% të interferencave në brezin 700 MHz me vendet fqinje brenda vitit 2027;

Lirimi i brezit DD2 nga përdorimi për shërbimet audiovizive synon gjithashtu të zgjidhë përfundimisht në masën 100 % problemin e intereferencave në këtë brez me Italinë, Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Kroacinë, që aktualisht e kanë dhënë/licensuar këtë brez për rrjetet 5G sipas përcaktimeve në Radio Rregulloret e ITU-së dhe Vendimit të BE-së për UHF.

b) Mbajtja 100% e rrjeteve të transmetimeve numerike tokësore ekzistuese pas lirimit të DD2 nga transmetimi televiziv, brenda vitit 2027;

Garantimi i pluralizimit në media dhe vazhdimësia e marrjes nga publiku të transmetimeve televizive pa ndërperje është një kërkesë thelbësore që lidhet me të drejtat kushtetuese.
Përmes këtij projektligji synohet të sigurohet ruajtja e shtatë rrjeteve numerike të transmetimeve televizive të licensura nga AMA si dhe vijimi i marrjes së programeve televizive nga publiku pa ndërprerje.

**OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

- **Opsioni 0: Status Quo-ja (s'ka rregullim ligjor);** Nuk është opsion i preferuar për shkak të nevojës imediate që del për lirimin e frekuencave të brezit 700 MHz në kuadër të harmonizimit të politikave spektrale si dhe dhënien e këtij brezi për shërbimet e gjeneratës së re 5G, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare për çështjet e frekuencave si dhe i kërkesave në procesin e integrimit me BE.

- **Opsioni 1 (i preferuar hartimi i një ligji të ri).** Kjo nismë ligjore synon që të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve televizive, që transmetohen nëpërmjet rrjeteve tokësore numerike, pas lirimit të brezit 700 MHz, përmes kompensimit të pjesshëm të kostove direkte që shkakton procesi i lirimit të brezit 700 MHz. Tjetër qëllim është të krijohen kushtet për lirimin e Digjital Dividentit Dy (DD2), që përdoret aktualisht për transmetime audiovizive numerike dhe kalimin e këtyre frekuencave në përdorim të rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme 5G, sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike, si dhe të përcaktojë masën e

kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave. Lirimi i këtij brezi është i domosdoshëm për të zgjidhur problemet e interferencave me vendet fqinje Itali, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Greqia si dhe kusht në kuadër të integrimit në BE.

- **Opsioni 2: Masa jorregullatore** - Ky opsion parashikon ndjekjen e një qasjeje jorregullatore, të bazuar në koordinimin institucional dhe bashkëpunimin vullnetar ndërmjet administratave të vendeve fqinje, AKEP-it, AMA-s dhe operatorëve të rrjeteve numerike tokësore, me qëllim zgjidhjen e interferencave ndërkufitare dhe realizimin e migrimit të transmetimeve jashtë brezit 700 MHz. Në këtë kuadër, do të zhvillohen negociata dhe koordinime teknike me vendet fqinje, do të synohet arritja e marrëveshjeve vullnetare me operatorët për rikonfigurimin e rrjeteve dhe migrimin e transmetimeve, si dhe do të hartohet një plan i përbashkët veprimi nga AKEP dhe AMA, me përcaktimin e afateve dhe përgjegjësive përkatëse. Gjithashtu, do të ofrohet asistencë teknike dhe do të lehtësohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe operatorëve për realizimin e procesit..

- **Opsioni 3: Nxjerrja e një akti nënligjor për të rregulluar situatën e krijuar.** Ky opsion parashikon hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për përcaktimin e procedurave teknike dhe administrative që lidhen me lirimin e brezit 700 MHz dhe migrimin e rrjeteve numerike. Ai mundëson një proces më të shpejtë dhe fleksibël në përcaktimin e mënyrës së zbatimit, duke reduktuar kohën dhe burimet institucionale krahasuar me miratimin e një ligji të ri. Megjithatë, zbatimi i këtij opsioni kushtëzohet nga ekzistenca e një baze të mjaftueshme ligjore, pasi aktet nënligjore nuk mund të krijojnë kompetenca apo detyrime të reja pa autorizim ligjor, veçanërisht për përcaktimin e përfituesve, masën dhe burimin e kompensimit financiar, si dhe përdorimin e fondeve publike. Për rrjedhojë, ky opsion mund të jetë i përshtatshëm për rregullimin e aspekteve teknike dhe procedurale të migrimit, por nuk është i mjaftueshëm për të garantuar një mekanizëm të plotë dhe të qëndrueshëm të kompensimit financiar të operatorëve të prekur.

**ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar. Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.*

**Opsioni 1, i preferuar** lidhet me lirimin e brezit të rëndësishëm të frekuencave të DD2 që janë caktuar ne nivel global dhe rajonal ne Evropë për përdorim për rrjetet 5G. Ky proces shoqërohet me ndikim ekonomik për Buxhetin e Shtetit, pasi projektligji parashikon shpenzime buxhetore në vlerën 6,432,500 Euro, të cilat pritet të kthehen nga të ardhurat që do krijohen për dhënien në përdorim të frekuencave që lirohen për rrjetet 5G. Në tërësi, procesi parashikon të ketë rritje të të ardhurave në buxhetin e shtetit, pasi licensimi për rrjetet 5G vlerësohet me të ardhura më të mëdha se kostoja e këtij procesi duke pasur parasysh të ardhurat nga licensimi dhe pagesat periodike për përdorimin e frekuencave që shkojnë në buxhetin e shtetit.

**Grupet e prekura dhe ndikimet kryesore**

1. Operatorët e rrjeteve të transmetimit televiziv tokësor dixhital

Operatorët RTSH, TV Klan, Top Channel, Digitalb, Vizion Plus dhe ADTN janë grupi më i drejtpërdrejtë i prekur nga zbatimi i nismës. Lirimi i brezit 700 MHz kërkon riorganizimin

dhe përshtatjen e rrjeteve të transmetimit televiziv, përfshirë rikonfigurimin e pajisjeve ekzistuese, zëvendësimin e një pjese të tyre dhe kryerjen e investimeve të nevojshme për vijimin e ofrimit të shërbimit në frekuencat e tjera të përcaktuara. Këto ndryshime sjellin ndikime financiare dhe ekonomike, për shkak të kostove të përshtatjes së infrastrukturës dhe pajisjeve, si dhe ndikime teknike dhe operacionale, që lidhen me procesin e migrimit dhe vijueshmërinë e transmetimit. Parashikimi i kompensimit të pjesshëm synon të lehtësojë barrën financiare që u krijohet këtyre operatorëve nga procesi i migrimit.

2. Qytetarët dhe konsumatorët e shërbimeve televizive
Qytetarët që përdorin shërbimet televizive tokësore dixhitale mund të preken gjatë periudhës së kalimit në frekuencat e reja, pasi procesi mund të shoqërohet me ndërprerje të përkohshme të sinjalit ose nevojën për të kryer kërkimin dhe rikonfigurimin e kanaleve televizive në pajisjet e tyre. Për këtë arsye, informimi paraprak dhe fushatat ndërgjegjësuese janë të rëndësishme për të kufizuar vështirësitë për konsumatorët. Nga ana tjetër, në planin afatgjatë, qytetarët pritet të përfitojnë nga zhvillimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, përfshirë teknologjinë 5G. Ndikimet për këtë grup janë kryesisht sociale dhe të lidhura me aksesin në shërbime, si dhe teknike, gjatë fazës së migrimit.

3. Operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Vodafone Albania dhe One Albania)
Lirimi i brezit 700 MHz krijon mundësi për përdorimin e këtyre frekuencave nga operatorët e komunikimeve elektronike për zhvillimin dhe zgjerimin e rrjeteve 5G dhe përmirësimin e kapaciteteve të shërbimeve të komunikimit me brez të gjerë. Për këta operatorë, ndikimi kryesor është pozitiv dhe ekonomik, pasi aksesi në këtë brez mund të mbështesë zgjerimin e mbulimit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Megjithatë, përdorimi i frekuencave do të shoqërohet edhe me detyrimet përkatëse financiare dhe administrative, përfshirë kostot e autorizimit dhe të përdorimit të spektrit.

4. Institucionet publike përgjegjëse për procesin
Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) kanë përgjegjësi të ndryshme, por të ndërlidhura në zbatimin e procesit. AMA do të angazhohet në verifikimin e kostove të paraqitura nga operatorët, koordinimin dhe mbikëqyrjen e procesit të migrimit, si dhe verifikimin e përmbushjes së detyrimeve përkatëse. AKEP do të ketë rol në verifikimin e lirimit të brezit dhe administrimin e frekuencave pas vënies së tyre në dispozicion për shërbimet e komunikimeve elektronike. Këto institucione do të përballen me ndikime administrative, institucionale dhe operacionale, që lidhen me nevojën për koordinim, kapacitete njerëzore dhe teknike, monitorim dhe kontroll të zbatimit të procesit.

5. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe Ministria e Financave
Këto institucione do të përfshihen në administrimin e procesit të kompensimit të pjesshëm të operatorëve dhe në sigurimin e fondeve përkatëse. Ndikimi kryesor për to është financiar dhe buxhetor, pasi zbatimi i opsionit të preferuar parashikon një angazhim të fondeve publike për mbulimin e kostove të migrimit. Sipas vlerësimit të paraqitur, kostoja totale e parashikuar për kompensimin e operatorëve është rreth 6.432 milionë euro. Përveç ndikimit buxhetor, procesi kërkon edhe angazhim administrativ për shqyrtimin, verifikimin dhe administrimin e fondeve dhe procedurave të kompensimit.

6. Vendet fqinje dhe administratat përkatëse të frekuencave

Procesi i lirimit dhe riorganizimit të brezit 700 MHz ka edhe një dimension ndërkufitar, pasi përdorimi i frekuencave në këtë brez kërkon koordinim me administratat e vendeve fqinje. Lirimi i brezit dhe harmonizimi i përdorimit të tij pritet të kontribuojnë në reduktimin e interferencave ndërkufitare që mund të ndikojnë në funksionimin e rrjeteve televizive dhe të komunikimeve elektronike. Për rrjedhojë, ndikimi për këtë grup është kryesisht teknik dhe ndërkufitar, me efekte pozitive në administrimin e spektrit dhe në cilësinë e shërbimeve.

**Përmbledhje e llojeve të ndikimeve**

Nga analiza e grupeve të prekura, ndikimet kryesore të nismës klasifikohen si më poshtë:

- Ndikime ekonomike dhe financiare: kostot e përshtatjes dhe zëvendësimit të pajisjeve të operatorëve televizivë, kompensimi i pjesshëm nga buxheti i shtetit dhe kostot që lidhen me autorizimin dhe përdorimin e frekuencave nga operatorët e komunikimeve elektronike.
- Ndikime teknike dhe operacionale: rikonfigurimi i rrjeteve televizive, migrimi në frekuenca të tjera, përshtatja e infrastrukturës, verifikimi i lirimit të brezit dhe administrimi i tij për përdorimin e ri.
- Ndikime sociale dhe te konsumatorët: mundësia e ndërprerjeve të përkohshme të shërbimit televiziv gjatë migrimit, nevoja për informimin e qytetarëve dhe përfitimet afatgjata nga përmirësimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike.
- Ndikime institucionale dhe administrative: angazhimi i AMA-s, AKEP-it dhe ministrive përgjegjëse në koordinimin, mbikëqyrjen, verifikimin dhe administrimin e procesit.
- Ndikime ndërkufitare: përmirësimi i koordinimit të frekuencave me vendet fqinje dhe reduktimi i interferencave ndërkufitare.

Në tërësi, nisma gjeneron fillimisht ndikime financiare, teknike dhe administrative, veçanërisht për operatorët televizivë dhe institucionet publike të përfshira në proces. Ndërsa në periudhën afatgjatë, ndikimet pritet të jenë kryesisht pozitive, përmes përdorimit më efikas të spektrit të frekuencave, zhvillimit të rrjeteve 5G dhe përmirësimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

**ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.*

- Pas shqyrtimit të alternativave, opsioni i preferuar përzgjidhet opsioni 1- miratimi i një ligji të ri për "Për lirimin e frekuencave të Digital Dividentit dy (DD2)"
- Përmes nismës ligjore për lirimin e brezit të frekuencave 700 MHz, synohet zgjidhja finale e problemit te intereferencave me vendet fqinje, si Itali, Greqi, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroaci, që aktualisht e kanë licensuar këtë brez për rrjetet 5G
- Qëllimi tjetër është interesi i përgjithshem publik për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve audiovizive të medias të ofruara përmes rrjeteve numerike tokësore; Miratimi i këtij projektligji është i rëndësishëm në lidhje me vijimin e ofrimit të shërbimeve të medias audiovizive numerike.
- Në vijim ky ligj i shërben përmbushjes së piketave përmbyllëse të integrimit për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media";
- Gjithashtu kjo nismë i shërben objektivit strategjik për zhvillimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë te se ardhmes.

**Opsioni i preferuar** shoqërohet me ndikim ekonomik për Buxhetin e Shtetit, por që do të kompensohet nga të ardhurat e pritshme që krijohen me dhënien në përdorim të frekuencave që lirohen për rrjetet 5G. Të ardhurat nga licesnimi i frekuencave per rrjetet e komunikimit elektronik derdhen ne Buxhetin e Shtetit. Këto të ardhura priten të jenë më të larta se sa kompensimi financiar i parashikuar për lirimin e DD2.

**Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

| Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 |
|---|---|---|
| **3,216,250 Euro** | **3,216,250 Euro** | **-** |

**KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse)*

Projektligji është hartuar me kontributin e Ministrisë për Infrastrukturën dhe Energjinë dhe Ministrisë së Financave, AMA, AKEP dhe në konsultim me përfaqësuesit e institucioneve anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr.113, datë 20.07.2022, "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për lirimin e Digital Divident dy (DD2)".

Projektligji është bazuar në rezultatet e asistencës teknike të financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të projektit Technical Assistance for The Telecommunications Sector, Specific Contract number: 300026749 — SIEA-2018-5578.

Në kuadër të asistencës teknike ekspertët e Bashkimit Evropian, kanë përgatitur strategjinë e migrimit të frekuencave, kanë dhënë rekomandime për çështjet rregullatore dhe të licensave që preken nga procesi, kanë propozuar metodologjinë për vlerësimin e kostove të migrimit mbështetur në praktikat e mira të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian si dhe kanë bërë një vlerësim të kostove të migrimit bazuar në rrjetet e zhvilluara për transmetimet audiovizive numerike të operatorëve private të licensuar nga AMA dhe nga RTSH.

Dokumentat e përgatitura nga konsulentët janë konsultuar me grupet e interesit, operatorët e rrjeteve numerike audiovizive si dhe institucionet e përfshira në tryeza dhe workshope të organizuara në bashkëpunim me AMA gjate vitit 2022 si dhe në workshopin e organizuar me datë 16 dhjetor 2022.

Projektligji i hartuar u diskutua/dakordësua në takimin e zhvilluar me datë 20.7.2023, të sekretariatit teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr. 113 datë 20.7.2022 "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për lirimin e Digital Divident Dy".

Projektligji është publikuar për konsultim publik me grupet e interesit përmes procedurës së konsultimit publik edhe në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit në periudhën 11.09.2025-09.10.2025. Gjatë muajit Shtator 2025 AMA ka organizuar takime me operatorët të cilët kanë ngritur shqetësimet e tyre në lidhje me shumën e kompensimit me konkretisht, vlera është përcaktuar në monedhën euro dhe vlerësimi është kryer në vitin 2022 pra tre vjet më përpara. Që nga ajo kohë ka pasur një zhvlerësim të monedhës Euro në raport me

monedhën lekë dhe për rrjedhoje duhet që vlera të jetë më e madhe në raport të drejtë me normën e zhvlerësimit. Gjithashtu është ngritur edhe shqetësimi që pajisjet që do zëvendësohen nuk mund të rishiten pasi ato nuk mund të përdoren me nga asnje vend tjetër. Në përfundim edhe çmimet për montimin instalimin, rikonfigurimin e rrjeteve janë rritur 25% krahasuar me periudhën e vlerësimit 2022. Pas konsultimit u ndermorr nje proces analize dhe rivlerësimi nga AMA me konsulentin e angazhuar gjatë asistencës teknike. Analiza e kryer në Janar - Shkurt 2026, nga AMA beri rivlerësimin e kostove të kompensimit në vlerën 6,432,500 Euro. Projektligji i rishikuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës (Urdhri i Kryeministrit nr. 69 dt. 3.4.2026) pas konsultimit dhe rivlerësimit reflekton vlerën e rishikuar nga konsulenti.
Në lidhje me procesin e konsultimit publik theksojmë se janë marrë 11 komente nga operatorët e transmetimeve televizive numerike kombëtare. Pjesa më e madhe e komenteve ka qenë e natyrës ekonomike dhe kishte lidhje me mënyrën e kompensimit dhe shumës së kërkuar për lirimin e brezit 700 MHz. Këto komente janë trajtuar pjesërisht për mënyrën e kompensimit dhe shumës së kërkuar, pasi projektligji parashikon kompensim të pjesshëm të kostove që lidhen vetëm me procesin e migrimit të frekuencave të DD2 dhe jo investime të reja. Kjo praktikë është ndjekur dhe në vendet e BE. Gjithashtu komentet u përcollën zyrtarisht AMA-s e cila ndërmorri procesin e rivlerësimit me ekspertin e huaj i cili adresoi pjeserisht shqetësimet e operatorëve. Ky rivlerësim u përfshi në projektligjin e rishikuar duke përditësuar shumën e kompensimit të pjesshëm për operatorët e transmetimeve televizive numerike kombëtare.

Vlen te theksohet gjithashtu se, vlera e kompenesimit për operatorët e përllogaritur nga konsulenti në vitin 2022 është kundërshtuar vazhdimisht nga operatorët. Për këtë arsye në vitin 2025 është bërë riaktivizimi i grupit ndërinstitucional i punës për draftimin e projektligjit dhe nxjerrjen e tij për konsultim publik në shtator-tetor 2025. Kjo gjëe solli dhe komentet e operatorëve që kishin lidhje me shumën e kompensimit financiar për lirimin e brezit 700 MHz të cilat u adresuan tek AMA e cila bëri dhe rivlerësimin me konsulentin e huaj dhe reflektimin e këtij rivlerësimi në projektligj. Kjo shpjegon dhe vonesat për mos realizimin e lirimit të këtij brezi.

**ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohet zbatimi dhe monitorimi*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e opsionit të preferuar janë:

AMA, është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjinë, , Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në bashkëpunim janë institucionet që do të ndjekin zbatimin e opsionit të preferuar për të mundësuar:

- lirimin e brezit 700 MHz dhe zgjidhjen e interferencave ndërkufituare,
- vazhdimin e ofrimit pa ndërprerje të shërbimeve të medias audiovizive përmes rrjeteve numerike tokësore;

- licensimin e ketij brezi nga AKEP për rrjetet 5G, pas lirimit të tij nga transmetimet numerike dhe,
- përmbushjen e piketave përmbyllëse të integrimit për Kapitullin 10“Shoqëria e informacionit dhe Media”.

AMA do të jetë institucioni kryesor i përgjegjësisë pasi do të kryeje rolin e monitorimit, dhe koordinimit me operatorët për procesin e migrimit si dhe bashkëpunimin me vendet fqinje në lidhje me interferencat. Çdo fazë e ndryshimeve të përcaktuara në procesin e lirimit do të raportohet dhe publikohet në mënyrë periodike nga AMA në periudha mujore pasi faza e migrimit që do të zgjasi 6 muaj. Në çdo raport do të përshkruhen hapat e ndjekur deri në atë moment, problematikat e hasura dhe hapat në vijim.

## PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

### Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Shqipëria në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian në lidhje me kapitullin 10: “Shoqëria e informacionit dhe Media” ka si detyrë lirimin e frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe kalimin e këtij brezi për përdorime për rrjetet 5G. Kjo është kërkuar edhe në piketat përmbyllëse për këtë kapitull.

Kuadri ligjor ekzistues që rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, është ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ky ligj është përafruar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë). Ne lidhje me frekuencat ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton që AMA licenson rrjetet e transmetimit audioviziv në frekuencat sipas Planit Kombetar të Frekuencave. Përcaktimet e detajuara per administrimin e frekuencave si një burim natyror i kufizuar dhe pasuri kombëtare bëhen në ligjin për komunikimet elektronike që referohet në ligjin nr. 97/2013.

Bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Strategjise për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike të miratuar me VKM nr. 292/2012, AMA ka licensuar pesë rrjete të transmetimit numerik audioviziv dhe dy rrjete të transmetimit numerik audioviziv janë ndërtuar dhe operohen nga RTSH.

Ligji nr. 54/2024 datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është ligji bazë në fushën e komunikimeve elektronike. Në ligjin për komunikimet elektronike përcaktohen rregullat për administrimin dhe menaxhimin në tërësi të spektrit të frekuencave duke parashikuar harmonizimin e Planit Kombëtar të Frekuencave me Radio Rrregulloret Ndërkombëtare të ITU-së si dhe me Planin Evropian të Alokimeve (ECA).

Plani Kombëtar i Frekukencave i miratuar me VKM nr. 756 date 13.12.2024, ka parashikuar që brezi i frekuencave 700 MHz do të kalojë për përdorim për rrjetet mobile broadband jo me vonë se dhjetor 2025. Ky përcaktim është bërë në përputhje me aktet finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit WRC-23 si dhe me Tabelën Evropiane të Alokimeve të Frekuencave ECA 2024.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 434 datë 3.6.2020, ka miratuar Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, ka përcaktuar si vizion: "Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit" dhe si objektiva strategjike të zhvillimit të Broadband. Me VKM nr. 636 datë 29.7.2020 "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit" u parashikua lirimi i frekuencave të Digital Dividentit dy (DD2), në afatin maksimal të vendosur nga Komisioni Evropian me Vendimin nr. 2017/899/EU, brenda datës 30.6.2022.

Me mbështjetjen e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) u hartua në vitin 2021 një plan frekuencash për transmetimet numerike audiovizive që do mundësonte lirimin e brezit 700 MHz duke siguruar vazhdimësinë e rrjeteve numerike ekzistuese dhe kapacitetet e tyre (numrin e programeve). Procesi i lirimit te frekuencave DD2, rezultonte si një proces kompleks që ndërthurte çështje teknike, ligjore, rregullatore dhe financiare si dhe kërkonte koordinim ndërkufitar për të siguruar operim pa interferenca të rrjeteve si audiovizive ashtu dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike të telekomunikacionit.

Gjatë vitit 2021 – 2022, u ndërmorr nga AMA një proces intensiv koordinimi ndërkufitar me takime bilaterale dhe multilaterale me të gjithë vendet e rajonit. Pas disa takimeve, dhe komunikimeve u arrit që në fund të shtatorit 2022, të dakordësohej për planin e frekuencave për lirimin e 700 Mhz. Mbi këtë bazë u përgatit me konsulentet e Bashkimit Evropian strategjia e migrimit si dhe metodologjia e vlerësimit te kostove dhe u bë përllogaritja e kostove të migrimit të frekuencave për rrjetet ekzistuese të transmetimeve numerike kombëtare.

Projektligji i përgatitur mbështetet në rezultatet e asistencës teknike për kostot e perllogaritura për kompensimin pjesor sipas metodologjisë së përdorur në disa vende të Bashkimit Evropian.

Projektligji synon që të mundësojë arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit, përmes mundësimit të zhvillimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë. Miratimi i këtij projektligji parashikohet të ketë ndikim të rëndësishëm në lidhje me vijimin e ofrimit te shërbimeve të medias audiovizive numerike.

Lirimi i brezit DD2 nga përdorimi për shërbimet audiovizive synon gjithashtu të zgjidhë një problem me intereferencat me vendet fqinje, si Itali, Greqi, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroaci, qe aktualisht e kanë dhënë/licensuar këtë brez për rrjetet 5G.

## Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*

- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Procesi i lirimit të brezit 700 MHz është kompleks pasi ndërthur si komponentë teknike ashtu dhe ato ligjore, rregullatore, por dhe financiare (kompensimi i kostove të migrimit).

Brezi i frekuencave 700 MHz, i njohur si Digital Divident dy (DD2) është aktualisht i përdorur nga operatorët e transmetimeve televizive kombëtare dhe Radio Televizioni Shqiptar mbi bazën e licensave të dhëna nga Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) që kanë vlefshmëri deri në vitin 2030-2032. Lirimi i këtij brezi ndërthur probleme teknike, rregullatore e financiare.
Adresimi i problemeve teknike është bërë duke hartuar planin e migrimit të frekuencave.
Zgjidhja teknike është e kushtëzuar nga kufizimi i frekuencave në dispozicion për këto transmetime dhe pamundësia e transferimit në frekuenca të tjera. Domosdoshmëria e zgjidhjes së interferencave përmes rikonfigurimit të rrjeteve, zmadhimit të alotmenteve duke siguruar mbulimin e territorit me më pak frekuenca.
Rikonfigruimi i alotmenteve dhe rrjeteve shoqërohet me impakt financiar pasi preken investimet e kryera mbi bazën e licencave që operatorët zotërojnë. Adresimi i këtij problemi nuk mund të bëhet me rregullimin ligjor në fuqi.

Ligji nr. 97/2013 nuk ka parashikime dhe burime për adresimin e këtij problemi. Digital Divident dy (DD2) është brez frekuencash i rëndësishëm për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve të së ardhmes, 5G për mbulim të gjerë kombëtar. Aktualisht vendet fqinje e kanë liruar këtë brez dhe e kanë alokuar për shërbimet 5G. Kjo ka sjellë një numër të madh interferencash me vendet fqinje të cilat janë raportuar herë pas here në drejtim të shtetit Shqiptar. Ky problem ka qenë edhe pjesë e agjendës së RSPG (Grupi Këshillimor p\ër Politikat Spektrale të BE-së) gjatë vitit 2023 -2026 në të gjitha mbledhjet. Nga përfaqësuesit e EC dhe vendeve fqinje kërkohet ne mënyrë te vijueshme lirimi sa me pare i këtij brezi.

Vendimi për lirimin e DD2 me qëllim përdorimi për rrjetet 5G, në nivel evropian është marrë nga Bashkimi Europian në vitin 2017. Afati maksimal i lirimit ishte vendosur 30.6.2022.

Me Vendimet e Këshillit të Ministrave të miratuara si më poshtë:
- VKM nr.756, date 23.12.2024 për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
- VKM nr. 434 date 3.6.2020 për miratimin e Planit Kombëtar të Broadbandit dhe
- VKM nr. 636 date 29.7.2020 për miratimin e dokumenti i politikave spektrale1,

është vendosur që brezi i frekuencave 700 MHz, të kalojë për mobile broadband, rrjetet 5G.

Për të zgjidhur problemet e mprehta te interferencave AMA ka bërë zgjidhje të përkohshme rast pas rasti, por pa liruar këtë brez nga përdorimi aktual nuk ka asnjë mundësi teknike për të gjetur zgjidhje përfundimtare për interferencat me vendet fqinje. Edhe pas këtyre zgjidhjeve të përkohshme nga AMA problemet me interferencat me vendet fqinje vazhdojnë dhe çdo zgjidhje provizore ka qenë e cunguar. E vetmja zgjidhje është lirimi i brezit 700 MHZ nga transmetimet televizive numerike kombëtare.

[1] *VKM nr. 434 datë 3.6.2020 "Për miratimin e Planit të qëndrueshëm për zhvillimin e infrastrukturës digjitale broadband 2020-2025" dhe VKM nr. 636 datë 29.7.2020 "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit"*

Gjatë vitit 2022, është punuar me asistencë teknike të Bashkimit Europian për procesin e lirimit të Digital Divident 2 (brezit 700 MHz). Në kuadër të asistencës teknike dhe në një proces bashkëpunimi me AMA, MIE dhe me konsultime me operatorët e televizioneve kombëtare janë përgatitur:

1. Strategjia për migrimin e frekuencave (zone pas zone/për çdo rrjet);
2. Vlerësimi per kostot e migrimit te frekuencave (për secilin rrjet/operator;
3. Rekomandimet për licensat/ceshtje rregullatore për AMA.

Kostot e vlerësuara për procesin e migrimit duke përfshirë dhe kostot për planin e komunikimit në total kostot për migrimin/lirimin e brezit 700 Mhz ishin vlerësuar ne vitin 2022 afersisht 5,14 mln. Euro.

Vlerësimi i kostove të migrimit të frekuencave është bërë nga konsulentët e BE sipas një metodologjie të përdorur në vendet e BE-së, duke u bazuar në numrin e stacioneve të transmetimit, fuqinë e transmetimit, çmimet referuese sipas transmetuesit (fuqisë).

Palët e prekura nga kjo nismë, janë ofruesit e shërbimeve mediatike audio/audiovizive, zotërues të rrjeteve numerike (RTSH, Klan TV, Top Channel, Digitalb, Vizion Plus, ADTN).

Metodologjia e propozuar parashikonte ripërdorimin pjesor të pajisjeve ekzistuese, rishitje të një pjese të tyre si dhe blerje pajisjesh të reja. Konsulentët kanë propozuar strategjinë për migrimin e frekuencave zonë pas zone / për çdo operator. Kohëzgjatja e këtij procesi është parashikuar 6 muaj.

Kuadri ligjor ekzistues që rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, është ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" i cili përcakton që AMA licenson rrjetet e transmetimit audioviziv në frekuencat sipas Planit Kombetar të Frekuencave. AMA ka licensuar në brezin e frekuencave 700 MHz pesë rrjete të transmetimit numerik audioviziv dhe dy rrjete të transmetimit numerik audioviziv janë ndërtuar dhe operohen nga RTSH.

Lirimi i frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe kalimi i tij për përdorime për rrjetet e komunikimeve elektronike të lëvizshme broadband është e lidhur me kërkesën për zbatimin e Vendimit të Bashkimit Evropian për brezin UHF, Vendimi (EU) 2017/899 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 17 Maj 2017, mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470-790 MHz në Bashkimin Evropian. Zbatimi i Vendimit të BE për brezin UHF është kërkesë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian, e përcaktuar në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues për Grupkapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, "Shoqëria e Informacionit dhe Media".

Plani Kombëtar i Frekukencave i përditësuar, i miratuar me VKM nr. 756 datë 13.12.2024, ka parashikuar që brezi i frekuencave 700 MHz do të kalojë për përdorim për rrjetet mobile broadband jo me vonë se dhjetor 2025. Ky përcaktim është bërë në përputhje me aktet finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit WRC-23 si dhe me Tabelën Evropiane të Alokimeve të Frekuencave ECA 2024.

Lirimi i brezit DD2 nga përdorimi për shërbimet audiovizive synon gjithashtu të zgjidhë një problem me intereferencat me vendet fqinje, si Itali, Greqi, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroaci, qe aktualisht e kanë dhënë/licensuar këtë brez për rrjetet 5G.

Procesi i lirimit nuk eshte kryer deri me tani per shkak se në mungesë të një akti specifik për lirimin e brezit 700 MHZ nuk mund të jepeshin zgjidhje për efektet financiare të procesit. Vetëm nëpërmjet një akti të tillë do të behet i mundur kompensimi i pjesshëm i operatorëve dhe do të fillojë procesi i lirimit.

Lirimi i brezit DD2 si një proces kompleks që ndërthur çështje teknike, ligjore, rregullatore, koordinim ndërkufitar me shume vende, dhe ka implikime financiare për operatorët që janë licensuar dhe kanë investuar për ndërtimin e rrjeteve të transmetimit numerik mbi bazën e licensave të lëshurara nga AMA dhe që pritet të marrin një kompensim të pjesshëm nga buxheti i shtetit.

*Grupet e prekura nga ky problem:*

**1. Publiku (qytetarët)**

Publiku, si përdorues përfundimtar i shërbimeve të transmetimit audioviziv, ndikohet nga problematika e përdorimit të brezit 700 MHz për transmetimet televizive dhe nga nevoja për koordinimin e përdorimit të këtij brezi me vendet fqinje. Mungesa e një zgjidhjeje të koordinuar për migrimin e frekuencave krijon pasiguri lidhur me vazhdimësinë dhe cilësinë e marrjes së sinjalit televiziv, si dhe rrezikun e ndërprerjeve apo degradimit të shërbimit për shkak të interferencave. Në këtë mënyrë, qytetarët mund të përballen me vështirësi në aksesin e pandërprerë në programet audiovizive, duke cenuar të drejtën e tyre për informim dhe akses në shërbimet mediatike.

**2. Operatorët e transmetimeve televizive të rrjeteve numerike tokësore**

Operatorët e transmetimeve televizive numerike kombëtare private (KLAN, TOP Channel, Digitalb, ADTN dhe Vizion Plus), si dhe RTSH, të cilët përdorin aktualisht frekuenca të brezit 700 MHz (DD2), përballen me nevojën për të përshtatur rrjetet e tyre të transmetimit me ndryshimet e kërkuara në përdorimin e spektrit të frekuencave. Mungesa e një kuadri të qartë dhe të koordinuar për lirimin e këtij brezi krijon pasiguri lidhur me afatet dhe mënyrën e migrimit, si dhe me kostot që shoqërojnë rikonfigurimin e rrjeteve, përshtatjen ose zëvendësimin e pajisjeve dhe kryerjen e ndërhyrjeve teknike. Gjithashtu, operatorët mund të përballen me humbje financiare për shkak të pajisjeve që nuk mund të ripërdoren apo të rishiten, si dhe me vështirësi në garantimin e vazhdimësisë së transmetimeve gjatë procesit të migrimit. Problematika prek edhe operatorët e tjerë që mbështeten në rrjetet numerike të operatorëve kombëtarë dhe të RTSH-së për ofrimin e shërbimeve të tyre.

**3. Autoritetet rregullatore (AMA dhe AKEP)**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) përballet me vështirësi në ushtrimin e funksioneve të tij rregullatore dhe mbikëqyrëse, për shkak të nevojës për të koordinuar përdorimin aktual të frekuencave nga operatorët audiovizivë me objektivin e lirimit të brezit 700 MHz. Mungesa e një procesi të strukturuar dhe të koordinuar migrimi krijon vështirësi në planifikimin dhe mbikëqyrjen e ndryshimeve teknike në rrjetet numerike, në koordinimin e operatorëve sipas

ndarjes territoriale të frekuencave (allotmenteve), si dhe në garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve audiovizive.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) përballet me kufizime në administrimin dhe planifikimin e përdorimit të spektrit të frekuencave për shërbimet e komunikimeve elektronike, për sa kohë brezi 700 MHz nuk është liruar dhe vënë në dispozicion për përdorimin e synuar. Kjo situatë pengon avancimin e procedurave për dhënien në përdorim të këtij brezi për rrjetet 5G dhe shtyn mundësinë e zhvillimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike që mbështeten në këtë spektër.

**4. Qeveria dhe institucionet përgjegjëse**

Qeveria dhe institucionet përgjegjëse, veçanërisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave, përballen me vështirësinë e përmbushjes së angazhimeve për lirimin e brezit 700 MHz, në përputhje me objektivat e politikës evropiane për harmonizimin dhe përdorimin e spektrit të frekuencave. Mospërcaktimi i një mekanizmi të qartë për migrimin e rrjeteve ekzistuese dhe trajtimin e kostove të lidhura me këtë proces krijon pasiguri për planifikimin financiar dhe institucional të ndërhyrjes. Gjithashtu, moslirimi në kohë i brezit kufizon mundësinë e vënies së tij në përdorim për rrjetet 5G dhe, rrjedhimisht, të gjenerimit të të ardhurave të mundshme për buxhetin e shtetit nga autorizimi i përdorimit të këtyre frekuencave. Qeveria përballet gjithashtu me vështirësinë e adresimit të problematikave të interferencave ndërkufitare dhe të përmbushjes së angazhimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian.

**5. Vendet fqinje**

Vendet fqinje, veçanërisht Italia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia, ndikohen nga përdorimi aktual i brezit 700 MHz në Shqipëri, për shkak të interferencave ndërkufitare që mund të cenojnë përdorimin e koordinuar të spektrit të frekuencave dhe cilësinë e shërbimeve të transmetimit audioviziv në territoret e tyre. Kjo situatë mund të sjellë ankesa dhe kërkesa të përsëritura për koordinim ndërmjet administratave përkatëse të spektrit, duke vështirësuar menaxhimin efikas të frekuencave dhe respektimin e marrëveshjeve të koordinimit ndërkufitar.

*Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Praktika e zhvilluar nga viti 2020 me aktet nenligjore si dhe masat teknike te marra nga rregullatori nuk ka cuar ne zgjidhje te problemit. Procesi shoqerohet me impakt financiar dhe kerkon nderhyrje përmes një akti ligjor. Propozimi sipas opsionit te preferuar permes nje ligji te vecante per lirimin e DD2, jep zgjidhje për kompensimin e pjesshëm për operatorët e transmetimeve numerike televizive dhe shmangjen e interferencave të shumta me vendet fqinje.

**Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Shqipëria është vend anëtar në ITU nga viti 1992. Si vend anëtar ka nënshkruar dhe ratifikuar Kushtetutën dhe konventën e ITU-së. Në lidhje me përdorimin e frekukencave Shqipëria ka detyrimin ndërkombëtar për garantimin e operimit pa interferenca të shërbimeve të radiokomunikimit. Në lidhje me përdorimin aktual të brezit 700 MHz për transmetime televizive, ka ankesa të vijueshme nga vendet fqinje: Itali, Greqi, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroaci.

***Lirimi i frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe kalimi i tij për përdorim për rrjetet e komunikimeve elektronike të lëvizshme broadband është e lidhur me kërkesën e BE në procesin e negociatave për zbatimin e Vendimit të Bashkimit Evropian për brezin UHF, Vendimi (EU) 2017/899 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 17 Maj 2017, mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470-790 MHz në Bashkimin Evropian. Zbatimi i Vendimit të BE për brezin UHF është kërkesë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian, e përcaktuar në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues[2] për Grupkapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, "Transformimi Digjital dhe Media".***

Kjo nismë hartohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 434 datë 3.6.2020, Plani i ri Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, i cili ka përcaktuar si vizion: "Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit".

Gjithashtu me VKM nr. 636 datë 29.7.2020 "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit" ishte parashikuar lirimi i frekuencave të Digital Dividentit dy (DD2), në afatin maksimal të vendosur nga Komisioni Evropian me Vendimin nr. 2017/899/EU, brenda datës 30.6.2022.

Gjithashtu Plani Kombëtar i Frekukencave i miratuar me VKM nr. 756 date 13.12.2024, ka parashikuar që brezi i frekuencave 700 MHz do të kalojë për përdorim për rrjetet mobile broadband jo me vonë se dhjetor 2025. Ky përcaktim është bërë në përputhje me aktet finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit WRC-23 si dhe me Tabelën Evropiane të Alokimeve të Frekuencave ECA 2024.

Lirimi i këtij brezi do të eliminonte dhe interferencat me vendet fqinje.

Qeveria me anë të kësaj nisme synon të realizojë kushtet për një kompensim të pjesshëm të kostove për operatorët e transmetimeve numerike televizive për të kryer procesin e lirimit të këtij brezi.

[2] https://enlargement.ec.europa.eu/news/accession-conference-albania-eu-opens-negotiations-competitiveness-and-inclusive-growth-cluster-2025-05-22_en

Nisma do të shërbejë për të arritur objektivat strategjike të qeverisë siç është integrimi në BE bashkë me përmbushjen e detyrimeve për kapitullin 10 që ka lidhje me Transformimin Digjital. Gjithashtu kalimi i këtij brezi për përdorimin e rrjeteve 5G do të nxiste modernizimin e tregut të komunikimeve elektronike me shërbime të reja në treg si dhe sigurimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Kjo nismë është ndërmarrë bazuar në rezultatet e asistencës teknike të financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të projektit "*Technical Assistance for The Telecommunications Sector, Specific Contract number: 300026749 — SIEA-2018-5578*".

Në kuadër të asistencës teknike ekspertët e Bashkimit Evropian, kanë përgatitur strategjinë e migrimit të frekuencave, kanë dhënë rekomandime për çështjet rregullatore dhe të licensave që preken nga procesi, kanë propozuar metodologjinë për vlerësimin e kostove të migrimit mbështetur në praktikat e mira të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian si dhe kanë bërë një vlerësim të kostove të migrimit bazuar në rrjetet e zhvilluara për transmetimet audiovizive numerike të operatorëve private të licensuar nga AMA dhe nga RTSH.

Ndër vite AMA ka ndërmarrë disa trajtime të rasteve të interferencave që janë të shumta në numër nga vendet fqinje si Italia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia por rezultatet kanë qenë zgjidhje të pjesshme pasi zgjidhja përfundimtare e interferencave do të realizohet vetëm me lirimin e brezit 700 MHz.

Dokumentat e përgatitura nga konsulentët janë konsultuar me grupet e interesit, operatorët e rrjeteve numerike audiovizive si dhe institucionet e përfshira në tryeza dhe workshope të organizuara në bashkëpunim me AMA.

Në lidhje me problematikën e interferencave me vendet fqinje gjatë periudhës së viteve 2022-2025, AMA ka bërë ndërhyrje pjesore në bashkëpunim me operatorët për të shmangur sa më shumë problematikat me vendet fqinje por zgjidhja përfundimtare e interferencave do të bëhet e mundur vetëm pas lirimit të plotë të këtij brezi.

Për adresimin e problemit me Urdhërin e Këshillit të Ministrave nr. 113 datë 20.7.2022, u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për lirimin e Digital Divident Dy". Në zbatim të këtij urdhri u përgatit dhe dakordësua në Grupin Ndërinstitucional të Punës draftligji për lirimin e DD2.

Gjithashtu, Strategjia e migrimit të frekuencave, e përgatitur me asistencën teknike të financuar nga Bashkimi Evropian dhe në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), përbën një dokument teknik dhe planifikues me rëndësi për realizimin e procesit të lirimit të brezit 700 MHz (DD2). Në këtë kuadër, është e nevojshme që në analizën e ndikimit të sqarohet më tej lidhja ndërmjet strategjisë së migrimit dhe nismës ligjore të propozuar, si dhe shkalla në të cilën kjo strategji është konkretizuar dhe zbatuar deri në momentin e hartimit të projektligjit.

## Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Ojektivat e synuar nëpërmjet kësaj politike janë:

a) Eliminimi i interferencave ndërkufitare në brezin 700 MHz, në koordinim me administratat përkatëse të frekuencave të Italisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Greqisë dhe Kroacisë, brenda një afati të përcaktuar pas lirimit të brezit.);

b) Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve audiovizive përmes rrjeteve numerike tokësore gjatë dhe pas procesit të migrimit, duke siguruar që të gjithë operatorët e prekur të kryejnë rikonfigurimin e rrjeteve dhe të ruajnë mbulimin e shërbimit sipas parametrave përkatës;

c) Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga kuadri i BE-së për lirimin dhe riplanifikimin e brezit 700 MHz, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet përkatëse të BE-së dhe dokumentet kombëtare të planifikimit të frekuencave.

d) Mundësimi i përdorimit të brezit 700 MHz për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të gjeneratës së pestë (5G), nëpërmjet përfundimit të procesit të riplanifikimit dhe licencimit të frekuencave përkatëse brenda vitit 2027, me synim zgjerimin e mbulimit me rrjete 5G në nivel kombëtar.;

**Objektivat specifike:**

a) Ulja ne nivelin 100% te interferencave ne brezin 700 MHz me vendet fqinje brenda vitit 2027;

Lirimi i brezit DD2 nga përdorimi për shërbimet audiovizive synon gjithashtu të zgjidhë perfundimisht në masën 100 % problemin e intereferencave në këtë brez me Italine, Greqine, Maqedonine e Veriut, Malin e Zi, Kroacine, që aktualisht e kanë dhënë/licensuar këtë brez për rrjetet 5G sipas percaktimeve ne Radio Rregulloret e ITU-se dhe Vendimit te BE-se per UHF.

b) Mbajtja 100% e rrjeteve te transmetimeve numerike tokesore ekzistuese pas lirimit te DD2 nga transmetimi televiziv, brenda vitit 2027;

Garantimi i pluralizimit në media dhe vazhdimësia e marrjes nga publiku të transmetimeve televizive pa ndërperje është një kërkesë thelbësore që lidhet me të drejtat kushtetuese.
Përmes këtij projektligji synohet të sigurohet ruajtja e shtate rrjeteve numerike të transmetimeve televizive te licensura nga AMA si dhe vijimi i marrjes se programeve televizive nga publiku pa nderprerje.

## Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

- **Opsioni 0: Status Quo-ja** (nuk ka rregullim ligjor dhe as masa jo rregullatore); Nuk është opsion i preferuar për shkak të nevojës që del për lirimin e frekuencave te brezit 700 MHz ne kuader te harmonizimit te politikave spektrale si dhe dhenien e ketij brezi per sherbimet e gjenerates se re 5G.
- **Avantazhet:** Nuk ka kosto të shtuara për t'u implementuar.
- **Disavantazhet**: Do pengonte procesin e integrimit ne BE pasi ka lidhje me kapitullin 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media" me afat zbatimi brenda vitit 2026 si dhe detyrimeve ndërkombëtare për çështjet e interferencave në frekuencat e vendeve fqinje në këtë brez.

- **Opsioni 1 (hartimi i një ligji të ri):** Pas shqyrtimit të alternativave, opsioni i preferuar përzgjidhet opsioni 1 - hartimi i ligjit te ri "Për lirimin e frekuencave të Digjiital Divident dy (DD2)".

**Avantazhet:**

- Hartimi i një ligji të ri mundëson krijimin e bazës së nevojshme ligjore për realizimin e procesit të lirimit të frekuencave të brezit 700 MHz (DD2), përfshirë përcaktimin e mekanizmave të kompensimit financiar për rrjetet ekzistuese që preken nga ky proces. Gjithashtu, ky opsion kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i integrimit evropian dhe angazhimet ndërkombëtare për harmonizimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, shmangien e interferencave me vendet fqinje dhe mundësimin e përdorimit të brezit për zhvillimin e rrjeteve 5G. Njëkohësisht, krijon kushtet për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të medias audiovizive dhe të së drejtës së informimit të qytetarëve.

**Disavantazhet:**

- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri kërkon kohë dhe burime administrative për procesin e hartimit, konsultimit dhe miratimit të tij. Gjithashtu, duke qenë se nisma nuk është parashikuar në Programin Analitik të Akteve për vitin 2026, mund të kërkojë rishikimin e planifikimit të akteve dhe angazhimin e burimeve shtesë institucionale. Procesi mund të shoqërohet edhe me kosto financiare për buxhetin e shtetit, në varësi të mekanizmit dhe nivelit të kompensimit që do të përcaktohet për rrjetet ekzistuese të prekura.

***Ky opsion është zgjidhja e vetme e të gjitha problematikave të përmendura në dokument.***

- **Opsioni 2 – Masa jorregullatore: Koordinimi dhe marrëveshjet vullnetare**
- Ky opsion do të konsistonte në:

1. Zhvillimin e negociatave dhe koordinimit teknik me administratat e vendeve fqinje për zgjidhjen e interferencave ndërkufitare.
2. Arritjen e marrëveshjeve vullnetare me operatorët e rrjeteve numerike tokësore për rikonfigurimin dhe migrimin e transmetimeve jashtë brezit 700 MHz.
3. Hartimin e një plani të përbashkët veprimi nga AKEP dhe AMA, me afate dhe përgjegjësi për secilin operator.
4. Ofrimin e asistencës teknike dhe lehtësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe operatorëve për realizimin e procesit të migrimit.

**Avantazhet:**
- Shmang nevojën për një proces të ri legjislativ dhe mund të nisë të zbatohet më shpejt.
- Mundëson fleksibilitet dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë me operatorët.
- Mund të ndihmojë në zgjidhjen e disa problematikave teknike dhe të interferencave përmes koordinimit ndërkufitar.

**Disavantazhet:**
- Zbatimi varet nga vullneti dhe gatishmëria e operatorëve për të pranuar migrimin dhe kushtet e tij.

- Nuk krijon vetvetiu bazë ligjore për kompensimin financiar të kostove të migrimit të operatorëve.
- Nuk garanton lirimin e plotë të brezit brenda afatit të përcaktuar, nëse nuk arrihet dakordësia me të gjithë operatorët.
- Nuk siguron detyrueshmërinë e masave dhe afateve ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë.

- **Opsioni 3: Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore.**

**Avantazhet:**
- Proces më i shpejtë i hartimit dhe miratimit të akteve, krahasuar me procedurën e miratimit të një ligji të ri.
- Fleksibilitet më i madh në përcaktimin e procedurave teknike dhe administrative për lirimin e brezit 700 MHz dhe migrimin e rrjeteve numerike.
- Mundësi për të përshtatur më lehtë procedurat e zbatimit me ndryshimet teknike dhe nevojat e operatorëve.
- Reduktim i kohës dhe burimeve institucionale që kërkohen për hartimin e një ndërhyrjeje të re ligjore, nëse ekziston një bazë ligjore e mjaftueshme.

**Disavantazhet:**
- Aktet nënligjore nuk mund të krijojnë kompetenca apo detyrime të reja që nuk kanë një autorizim të qartë në ligj, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e përfituesve dhe vendosjen e kompensimit financiar.
- Pamundësia për të përcaktuar me akte nënligjore, në mungesë të delegimit ligjor, masën e kompensimit, burimin e financimit dhe detyrimin për përdorimin e fondeve publike.
- Rreziku i cenimit të hierarkisë së akteve normative dhe sigurisë juridike, nëse përmes akteve nënligjore synohet të rregullohen çështje që kërkojnë ndërhyrje në nivel ligjor.
- Mungesa e një kuadri të plotë ligjor mund të krijojë paqartësi për kompetencat dhe përgjegjësitë e AMA-s, AKEP-it dhe institucioneve të tjera të përfshira.
- Vështirësi në garantimin e një mekanizmi të qëndrueshëm, transparent dhe të njëtrajtshëm për administrimin dhe shpërndarjen e kompensimit financiar për operatorët e prekur.

Ky opsion mund të jetë i përshtatshëm për rregullimin e aspekteve teknike dhe procedurale të procesit të migrimit, por nuk do të ishte i mjaftueshëm për të adresuar çështjet që kërkojnë bazë të posaçme ligjore, veçanërisht kompensimin financiar dhe përdorimin e fondeve publike.

## Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
    - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
    - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*

- *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

- *Diskutoni kufizimin e analizës:*

  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

- *Përmblidhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  - *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Palët e prekura prej opsionit të preferuar, janë si me poshte:

1. Operatorët e rrjeteve numerike Klan TV, Top Channel, Digitalb, Vizion Plus, ADTN dhe RTSH-në: si përfitues të drejtpërdrejtë të kompensimit te pjesshem financiar dhe njëkohësisht subjekte që duhet të kryejnë investime dhe ndryshime teknike në infrastrukturën ekzistuese.
2. Operatorët e rrjeteve numerike dhe RTSH-në: për të evidentuar nëse dhe në çfarë mase preken nga ndryshimet e rrjeteve, veçanërisht në lidhje me vazhdimësinë e transmetimit të programeve.
3. AMA: si institucioni përgjegjës për verifikimin e kostove, koordinimin me operatorët për procesim e migrimit, dhe raportimin tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pasi është verifikuar lirimi i brezit 700 MHz..
4. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën për detyrimet që lidhen me kompensimin e pjesshem per operatoret dhe transferimin e fondeve.
5. AKEP: për verifikimin e lirimit te brezit 700 MHz dhe administrimin e frekuencave pas lirimit të tyre si dhe dhënien në përdorim për rrjetet 5G.
6. Operatorët e komunikimeve elektronike të lëvizshme Vodafone dhe One: si përfitues të mundshëm të përdorimit të frekuencave të liruara, por edhe si subjekte që do të përballojnë kostot përkatëse të autorizimit dhe shfrytëzimit të tyre.Konsumatorët dhe publiku: si përfitues të mundshëm të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike, por edhe si subjekte që mund të preken përkohësisht nga ndryshimet teknike dhe rikonfigurimi i rrjeteve televizive.

***Publiku (qytetarët):*** Marrësit e shërbimeve të transmetimeve audiovizive gjatë procesit të lirimit të brezit 700 MHz dhe kalimit të transmetimeve televizive në frekuenca të tjera, mund të kenë ndërprerje afatshkurtra me marrjen e sinjalit televiziv. Me qëllim zbutjen e këtij efekti parashikohet të ketë fushata informimi gjatë procesit të migrimit me qëllim informimi, dhe marrje masash për rizgjedhje/kërkim të kanaleve të transmetimit në frekuencat e reja pas lirimit

të brezit 700 MHz. Projektligji synon garantimin e vazhdimësisë së transmetimeve numerike që është i rëndësishem për të siguruar aksesin në marrjen e transmetimeve.

***Operatorët e transmetimeve televizive të rrjeteve numerike tokësore***: Operatorët e transmetimeve televizive numerike kombëtare private (KLAN, TOP Channel, Digitald, ADTN dhe Vizion Plus) që kanë në përdorim frekuenca të brezit të DD2 si dhe RTSH impaktohen nga lirimi i këtij brezi, pasi do te angazhohen ne zbatimin e strategjise se migrimit si dhe ne kryejen e rikonfigurimit te rrjeteve, pajisjeve etj. Indirekt ky proces ndikon edhe tek operatorët e tjerë që mbështesin transmetimet e tyre tek rrjetet numerike të operatorëve kombëtarë dhe RTSH. Përmes projektligjit synohet të zbutet impakti financiar që shoqeron procesin e lirimit te DD2.

Publiku dhe operatorët e transmetimeve televizive të rrjeteve numerike tokësore janë grupet që ndikohen drejtpërdrejtë pasi në rastin e publikut do të ketë ndërprerje afatshkurtra me marrjen e sinjalit televiziv ndërsa për operatorët e transmetimeve televizive të rrjeteve numerike tokësore ndikimi është i drejtpërdrejtë pasi ka ndikim financiar në procesn e lirimit të këtij brezi.

***Autoritetet rregullatore:*** Autoriteti Mediave Audiovizive AMA, si autoriteti rregullator në fushën e medias audiovizive do të mbikqyrë gjithë procesim e lirimit të brezit 700 MHZ, koordinimin e gjithë prosecin me operatorët e transmetimeve numerike për lirimin mbi bazë allotmentesh të frekuencave sipas strategjisë së migrimit. AMA do të bashkëpunojë me institucionet e tjera si, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKEP në këtë proces.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP, do të bashkëpunojë me AMA gjatë procesit të lirimit të frekuencve si dhe në përfundim të procesit të lirimit të brezit 700 MHz do të administrojë këtë brez për ofrimin e shërbimit të rrjeteve 5G. Licesnimi i këtij brezi për rrjetet 5G do të sigurojë të ardhura për buxhetin e shtetit.

AMA do të jetë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikqyrjen e zgjidhjes së procesit te propozuar ndërsa AKEP do të jetë përgjegjës për administrimin e brezit të liruar.

***Qeveria:*** Procesi i lirimit të brezit 700 MHZ shoqerohet me impakt financiar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do jetë e angazhuar gjatë procesit me qëllim sigurimin e kompensimit të pjesshëm të kostove direkte që shoqëron procesin. Gjithashtu do të bashkëpunohet me autoritetet rregullatore për zbatimin në kohë të strategjisë të migrimit për frekuencat 700 MHz, gjashtë muaj nga miratimi i projektligjit dhe mundësimin e dhënies në përdorim të këtij brezi për shërbimet e rrjeteve 5G për marrjen e të ardhurave për buxhetin e shtetit. Qeveria do të përmbushe dhe detyrimet ndaj BE-së për lirimin e këtij brezi dhe shmangjen e interferencave me vendet fqinje.

***Vendet fqinje:*** Lirimi i këtij brezi sjellë impakt pozitiv për vendet fqinje si: Italia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroaci, pasi do të zgjidhë problemin me interferencat me vendet fqinje dhe do të çoje në uljen e ankesave të tyre.

Propozimi ligjor ka si qëllim që të garantojnë vijimin e ofrimit të shërbimeve të medias audiovizive dhe pa ndërprerje për publikun duke ofruar kompensim financiar te pjesshëm.

**Opsioni i preferuar** shoqërohet me ndikim ekonomik, (kosto) për Buxhetin e Shtetit, pasi lidhet me lirimin e brezit të rëndësishëm të frekuencave të DD2, si dhe frekuencave të tjera të lira dhe që janë caktuar për përdorim për rrjetet 5G. Kjo ka një kosto totale prej 6.432 Milion Euro për buxhetin e shtetit por që do të kompensohet nga të ardhurat e pritshme që do krijohen për dhënien në përdorim të frekuencave që lirohen për rrjetet 5G dhe që derdhen ne Buxhetin e Shtetit. Këto të ardhura priten të jenë më shumë sesa ndikimi në buxhet për këtë proces pasi operatorët mobile kanë shprehur prej kohësh gadishmërinë për ta përdorur këtë brez për shërbimet e rrjeteve 5G.

Në kuadër të këtij projekligji, është bërë një vlerësim për kostot e nevojshme për masat zbatuese për ndryshimet e pritshme të rrjeteve nga ana e operatorëve TV si dhe për informimin e publikut për këto ndryshime sipas tabelës më poshtë.

| Masa Zbatuese | Institucioni përgjegjës per zbatimin | Kosto per AMA (vetëfinancim) | 2026 | 2027 | Buxheti 2026-2027 |
|---|---|---|---|---|---|
| Kompensimi i pjesshëm i kostove të migrimit të frekuencave të brezit 700 MHz | AMA MIE | - | **3,216** milion Euro | **3,216** milion Euro | 6.432 milion Euro |

**Tabela e shpërndarjes së kompensimit sipas operatorëve rrjetet e të cilëve preken nga procesi i lirimit të DD2**

| OPERATORI I RRJETIT NUMERIK | VLERA E KOMPENSIMIT[3] NE EURO |
|---|---|
| DIGITALB TOPCHANNEL ADTN | 1,157,500 |
| TV KLAN | 1,155,600 |
| VIZION PLUS/TRING | 671,500 |
| RTSH | 3,447,900 |
| **TOTAL** | **6,432,500** |

Rezultatet e vlerësimit të kostove janë kryer nga ekspertët e Bashkimit Evropian mbi bazën e metodologjisë si më poshtë:

[3] Sipas analizës së kostove të kryer në vitin 2026

Metodologjia e llogaritjes së kostove të kompensimit është mbështetur në praktikat e mira të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe rezultatet e asistencës teknike të ofruar nga ekspertët e Bashkimit Evropian.

Metodologjia bazohet në stacionet e transmetimit sipas konfigurimit të rrjetit/eve ekzistuese dhe fuqisë së transmetimit si dhe çmimeve përkatëse për transmetuesit sipas fuqisë së transmetimit. Metodologjia grupon transmetuesit në grupe sipas fuqisë së transmetimit dhe merr parasysh situatën aktuale të rrjetit mbi bazën e raportimit të kryer nga vetë operatorët dhe verifikimit të kryer nga AMA.

Metodologjia supozon që:

- 60% e pajisjeve të instaluara do të ripërdoren pas rikonfigurimit të rrjetit/eve;
- Kostoja për rikonfigurimin vlerësohet të jetë 20% e kostos së produktit të ri (përfshirë transportin dhe punimet);
- Nga pajisjet që nuk do të riinstalohen, një pjesë mund të riblihet nga prodhuesi (në shumicën e rasteve) ose nga shoqëri të specializuara për rinovime;
- Përllogaritet se 50% e pajisjeve të mbetura do të rishiten për 25% të vlerës fillestare;

Formula për të përllogaritur vlerën e rikuperuar të pajisjeve është:

$PV$R=1−((1−$P$RETRO)+ $P$Retro×$C$Retro)−$P$sold×(1−$P$Retro)×$PVsold$)

Ku:

- $PVR$ është përqindja e vlerës së pajisjeve që do të rikuperohet mesatarisht
- $PRetro$ është përqindja e pajisjeve të ripërdorura pas rikonfigurimit
- $CRetro$ është kostoja e rikonfigurimit (përqindja e kostos së produktit)
- $PSold$ është përqindja e produkteve të shitura
- $PVSold$ është çmimi i shitjes për pajisjet e vjetra (përqindja e kostos së produktit)

Bazuar në shifrat e mësipërme, vlera e rikuperuar është

$PRetro$ = 60%
$CRetro$ = 20%

$PSold$ = 50%
$PVSold$ = 25%

Atëherë $PVR$ = 53%

Metodologjia përfshin dhe vlerësimin për shërbimet/punën bazuar në kostot standarde të fuqisë punëtore në Shqipëri dhe në BE si dhe bazuar në shërbimet e nevojshme që lidhen me rikonfigurimin e rrjeteve, instalimin, mbikqyrjen etj.

Përsa i përket ndikimeve jo të drejtperdrejta, pritet që ky ndryshim të sjellë ndikime sociale për komunitetin pasi do të përfitojne nga përdorimi i ketij brezi për teknologjinë e re 5G si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të komunikimeve me shpejtësi të lartë Gigabit. Vlen të theksohet se përdorimi i brezit 700 MHz për teknologjineë 5G është i domosdoshëm për arritjen e objektivave të operatorëve mobile në lidhje me mbulimin e popullsisë me sinjal 5G, rritjen e kapaciteteve të transmetimit për shërbime të ndryshme dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve mobile.

Vlen të theksohet se kompensimi financiar do të bëhet në proporcion me sasinë e stacioneve që operatorët kanë në funksion dhe nuk do të ndikojë në konkurrencën në treg. Mënyra e shpërndarjes së kompensimit, sipas tabelës së kostove të përcaktuar në lidhjen 1 të projektligjit, garanton trajtim të barabartë dhe proporcional për të gjithë operatorët.

Procesi i lirimit të brezit 700 MHz kërkon që ndryshimet në rrjet të kryhen njëkohësisht nga të gjithë operatorët e rrjeteve numerike TV në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të shërbimeve për konsumatorët. Procesi i lirimit të këtij brezi mund të ketë edhe vonesa që mund të kenë lidhje me realizimin në kohë të investimeve dhe ndryshimeve teknike nga një ose disa operatorë, duke penguar lirimin e njëkohshëm të frekuencave. Për të shmangur këtë gjë është parashikuar që nga hyrja në fuqi e projektligjit operatoret kanë kohë deri në 6 muaj për zbatimin e lirimit të brezit 700 MHz pasi ky është dhe kushti që do tu mundësonte atyre dhe marrjen e këstit të dytë të kompensimit.

**Rivlerësimi i kryer në vitin 2026 konsiston në:**

Rivlerësimi ka përdorur të njëjtën metodologji zbritëse (top-down) në nivel rrjeti, duke reflektuar zhvillimet teknologjike, ekonomike dhe operacionale të periudhës pasuese dhe duke garantuar përputhshmëri me praktikat më të mira evropiane për procese të ngjashme.

Llogaritja bazohet në koston totale të migrimit, e vlerësuar mbi bazën e konfigurimeve të stacioneve dhe niveleve të fuqisë së transmetimit të tyre, nivelit të angazhimit dhe kohës së nevojshme për procesin e migrimit, si dhe çmimeve aktuale të pajisjeve dhe shërbimeve. Kostot strukturohen në:

- kostot e pajisjeve, të cilat përfaqësojnë 80% deri në 85% të kostos totale, në varësi të numrit të shtresave (layers) të operuara nga secili operator;
- kostot e shërbimeve dhe fuqisë punëtore, të cilat përfaqësojnë 15% deri në 20%

**Vlerësimi pasqyron parametrat e mëposhtëm:**

- zëvendësimin e shumicës së pajisjeve ekzistuese me pajisje të reja;
- mungesën e një tregu funksional për pajisje të përdorura (second-hand);
- një rritje të përgjithshme të kostove të pajisjeve gjatë 4 viteve të fundit me rreth 19%;
- një rritje prej 4% të kostove të shërbimeve gjatë të njëjtës periudhë (fuqi punëtore evropiane dhe vendase);
- ndikimin e ndryshimeve të kursit të këmbimit EUR-LEK ndërmjet viteve 2022 dhe 2026.

Kompensimi përcaktohet mbi bazën e të dhënave të agreguara të rrjetit, dhe merr në konsideratë karakteristikat e stacioneve dhe standardet orientuese të kostove.

Metodologjia përfshin dhe vlerësimin për shërbimet/punën bazuar në kostot standarde të fuqisë punëtore në Shqipëri dhe në BE si dhe bazuar në shërbimet e nevojshme që lidhen me rikonfigurimin e rrjeteve, instalimin, mbikqyrjen etj.

Vonesat në miratimin e ligjit do të sillnin vonesa të mëtejshme në lirimin e frekuencave të DD2 që do të përdoren për rrjetet e gjeneratës së ardhme 5G, vonesa në zgjidhjen e interferencave me vendet fqinje (Itali, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Greqia, Kroaci) dhe mbi të gjitha nuk do të përmbushte plotësimin e kërkesave në kuadër të procesin të integrimit me BE dhe arritjen e objektivave të përcaktuara për kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” që duhet përmbyllur brenda vitit 2026.

## Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1, i preferuar për një ligj të ri "Për lirimin e frekuencave të Digjiital Divident dy (DD2)" do të shërbejë për zgjidhjen e problemit me intereferencat me vendet fqinje, si Itali, Greqi, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroaci, që aktualisht e kanë dhënë/licensuar këtë brez për rrjetet 5G, për zgjidhjen e një problemi të rëndësishëm me interes të lartë publik, sikurse është garantimi i së drejtës së informimit, nëpërmjet vijimit të marrjes së shërbimeve mediatike pas kalimit të plotë në transmetimet numerike dhe që synon të rregullojë vazhdimësinë e shërbimeve të medias audiovizive, plotësimin e kërkesave në kuadër të negociatave për integrimin në BE për Kapitullin 10 "Shoqeria e Informacionit dhe media" si dhe të hapë rrugën për përdorimin e tyre për zhvillimin e rrjeteve me shpejtësi shumë të lartë 5G të së ardhmes.

Përzgjedhja e Opsionit 1 si opsioni i preferuar bazohet në vlerësimin krahasues të alternativave të shqyrtuara dhe në aftësinë e tij për të adresuar në mënyrë të plotë problemin e identifikuar. Ndryshe nga Opsioni 0 (status quo), i cili nuk parashikon ndërhyrje dhe për rrjedhojë nuk mundëson lirimin e brezit 700 MHz dhe zgjidhjen e problematikave të interferencave me vendet fqinje, hartimi i një ligji të ri krijon bazën e nevojshme ligjore për realizimin e procesit dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve audiovizive. Gjithashtu, ndryshe nga Opsioni 2 (miratimi i një akti rregullator) dhe Opsioni 3 (nxjerrja e akteve nënligjore), të cilët nuk konsiderohen të përshtatshëm për të rregulluar në mënyrë të plotë çështjen e kompensimit financiar të operatorëve të prekur, Opsioni 1 mundëson përcaktimin me ligj të përfituesve, masës së kompensimit, burimit të financimit, kritereve të shpërndarjes dhe procedurave të administrimit e të pagesës së tij. Në këtë mënyrë, ky opsion ofron siguri juridike dhe transparencë për subjektet e prekura, krijon kushtet për koordinimin e ndërhyrjeve teknike nga operatorët dhe mundëson realizimin e objektivave të politikës brenda afateve të kërkuara në kuadër të angazhimeve evropiane dhe ndërkombëtare. Për këto arsye, Opsioni 1 vlerësohet si alternativa më efektive dhe e zbatueshme për adresimin e problemit, pavarësisht kostos financiare që shoqëron zbatimin e tij.

Projektligji nuk synon transpozimin e ndonjë acquis të posacme por është në zbatim të Vendimin e Komisionit Evropian 2017/899/EU për lirimin e frekuencave të njohura si DD2.

Projektligji "Për lirimin e frekuencave të digjital – dividentit 2", lidhet me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportet e BE-së për Shqipërinë nga viti 2022 për Kapitullin 10 "Shoqeria e Informaiconit dhe media" dhe në vijim ***si dhe plotësimin e kërkesave në kuadër të negociatave për integrimin në BE për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe media".***

Edhe pse ky projektligj shoqërohet me ndikim ekonomik për Buxhetin e Shtetit, pasi Projektligji parashikon shpenzime buxhetore në vlerën 6.432 milion Euro, të cilat pritet të kompensohen nga të ardhurat që do krijohen për dhënien në përdorim të frekuencave që lirohen për rrjetet 5G. Kjo nuk do të ndikojë tek operatorët pasi kompensimi i pjesshëm për çdo operator do të bëhet në bazë të numrit të stacioneve në funksion. Në tërësi, procesi parashikon të ketë rritje të të ardhurave në buxhetin e shtetit, pasi licensimi per rrjetet 5G do te jete me te ardhura me te medha se kostoja e ketij procesi.

Përmes këtij opsioni synohet përmbushja e objektivave për:

- Sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve audiovizive përmes rrjeteve numerike;
- Lirimin e frekuencave të DD2 për rrjetet 5G;
- Zgjidhjen e interferencave me vendet fqinje;
- Plotësimin e kërkesës në kuadër të negociatave të integrimit me BE për Kapitullin 10.

**Analiza me shumë kritere**

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative:

- Efikasiteti në përdorimin e frekuencave të brezit UHF/DD2 për transmetime audiovizive dhe rrjete 5G, duke maksimizuar shfrytëzimin dhe minimizuar interferencat– 5;
- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe sigurimi i të drejtës për informim për qytetarët përmes transmetimeve të pandërprera– 5;
- Efikasiteti i koordinimit ndër-institucional (AMA, OSHMA, institucione shtetërore) për zbatimin e lirimit të brezit 700 MHz/DD2 në përputhje me afatet e planifikuara– 4;
- Përputhshmëria me kërkesat e BE-së për integrimin – 5
- Kosto – efektiviteti – 4;

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

| **Kriteret** | **Pesha** | **Opsioni 0** | **Opsioni 1** | **Opsioni 2** | **Opsioni 3** |
|---|---|---|---|---|---|
| Efikasiteti në përdorimin e frekuencave të brezit UHF/DD2 për transmetime audiovizive dhe rrjete 5G, duke maksimizuar shfrytëzimin dhe minimizuar interferencat | 5 | 0 (0) | 5 (25) | 1 (5) | 2 (10) |
| Efikasiteti i koordinimit nder-institucional (AMA, OSHMA, institucione shteterore) per zbatimin e lirimit te brezit 700 MHz/DD2 ne perputhje me afatet e planifikuara | 4 | 1 (4) | 4 (16) | 2 (8) | 3 (12) |
| Përputhshmëria me kërkesat e BE-së për integrimin | 4 | 0 (0) | 4 (16) | 0 (0) | 1 (4) |
| Kosto – efektiviteti | 5 | 1 (5) | 5 (25) | 2 (10) | 3 (15) |
| Pikët | | 9 | 82 | 18 | 41 |

Sipas analizës me shumë kritere, opsioni 1, për një ligj te ri "Për lirimin e frekuencave të Digjiital Divident dy (DD2)", merr më shumë pikë dhe për këtë shkak është vlerësuar si opsioni i preferuar.

**Çështje të zbatimit**

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Struktura e ngarkuar për zbatimin e opsionit të preferuar është Autoriteti i Mediave Audiovizive, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu do të duhet edhe një koordinim i mirë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për të iniciuar dhënien në përdorim të brezit që lirohet për rrjetet 5G.

AMA do të jetë institucioni kryesor përgjegjës pasi do të kryeje rolin e monitorimit, dhe koordinimit me operatorët për procesin e migrimit si dhe bashkëpunimin me vendet fqinje në lidhje me interferencat. AMA do të raportojë në periudha mujore për fazat e migrimit që do të zgjasi 6 muaj. Përsa i përket alokimit të kompensimit, Ministria e Infrastruktures dhe Energjise do të disbursojë pjesën e parë prej 50 % tek operatorët sipas specifikimeve në aneks për shumën e kompensimit. Më pas në përfundim të migrimit mbas verifikimeve teknike nga ana e AMA, AKEP dhe koordinimit me vendet fqinje për interferencat, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të bëjë shpërndarjen e pjesës së dytë prej 50 %.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur jane si më poshtë:

- vonesa nga operatorët në porositjen e pjesëve dhe implementimin e ndryshimeve
- problemet teknike që mund të ndodhin gjatë migrimit
- mos koordinim ndër-institucional midis palëve të përfshira në proces
- vonesa në dhënien e kompensimeve

Masat për të minimizuar pengesat janë si më poshtë:

- porositja në avancë e pjesëve nga ana e operatorëve para fillimit të procesit të ndryshimeve dhe ndjekje me rigorozitet e hapave te migrimit nga ana e operatorëve
- parashikimi i problemeve teknike nga ana e operatorëve dhe përgatitja e një plani emergjence nga ana e tyre
- bashkëpunim i ngushtë ndërinstitucional
- dhënia në avancë e kompensimit fillestar dhe përgatitja e procedurave të kompensimit sa me shpejt për fazën finale të përfundimit të ndryshimeve

Masat të tjera që do të ndërmeren ne lidhje me ndryshimet që do bëhen përfshijnë:

1. Alokimin e kompensimit financiar nga buxheti i shtetit fillimisht në masën 50 % për kompensimin e operatorë të rrjeteve numerike që preken nga procesi;
2. Ndjekja e fazave të procesit të lirimit te brezit 700 MHz sipas allotmentëve dhe strategjisë së migrimit;
3. Verifikimi i lirimit të brezit dhe alokimi i pjesës së mbetur prej 50 % për operatorët në përfundim të procesit të lirimit të brezit 700 MHz;
4. Koordinim midis operatorëve dhe vendeve fqinje gjate gjithë procesit;
5. Komunikim i vazhdueshëm me abonentët/konsumatorët për të mos pasur humbje të sinjalit të kanaleve TV;
6. Fushata komunikimi për njoftimin e publikut për ndryshimet në kanalet e transmetimit;

Ky opsion nuk do të ketë nevojë për miratimin e akteve të tjera nënligjore dhe do të shërbejë vetëm për procesin e kompensimit të pjesshëm për operatorët me 50 % kompensim para fillimit të procesit dhe pjesën tjetër prej 50 % në përfundim të procesit të migrimit të frekuencave. Gjithashtu, ky projektligj nuk ndërvepron me ligjet e tjera ekzistuese dhe është i ngjashëm me praktikat e ndjekura në BE.

**Faza e shqyrtimit/vlerësimit**

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Duke qenë se procesi i lirimit te brezit 700 MHz është kompleks dhe kërkon një koordinim mjaft të mirë midis operatorëve TV, ajo do të mbikqyret nga AMA në koordinim edhe me institucionet e tjera. AMA do të jetë institucioni kryesor i përgjegjësisë pasi do të kryeje rolin e monitorimit, dhe koordinimit me operatorët për procesin e migrimit si dhe bashkëpunimin me vendet fqinje në lidhje me interferencat. Çdo fazë e ndryshimeve të përcaktuara në procesin e lirimit do të raportohet dhe publikohet në mënyrë periodike nga AMA në periudha mujore pasi faza e migrimit që do të zgjasi 6 muaj. Ne cdo raport do te pershkruhen hapat e ndjekur deri ne ate moment, problematikat e hasura dhe hapat ne vijim. Nderkohe AMA do te beje dhe koordinimin me vendet fqinje për interferencat gjate gjithe procesit te migrimit. Më pas në përfundim të migrimit mbas verifikimeve teknike nga ana e AMA, AKEP dhe koordinimit me vendet fqinje për interferencat, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të bëjë shpërndarjen e pjesës së dytë te kompensimit financiar.

Si tregues të arritjes së objektivave do të shërbejnë:

1. Përqindja e hapave të planifikuar të procesit të migrimit të përfunduar brenda afateve, si dhe përfundimi i procesit brenda 6 muajve nga fillimi i zbatimit të ligjit. Si bazë për matjen e treguesit: 0% e hapave të përfunduar në momentin e fillimit. Objektiv: 100% e hapave të përfunduar brenda 6 muajve.;

2. Numri i ndërprerjeve të shërbimit audioviziv gjatë migrimit do të jetë minimal, kohëzgjatja sa më e vogël dhe përqindja e qytetarëve të prekur do të jetë në varësi të zonave ku do kryhet lirimi i brezit.
3. Marrëveshjeve/protokolle të koordinimit të përfunduara me të gjithë vendet fqinje të prekura nga interferencat duke rezultuar në zero interferenca në përfundim të procesit.;
4. Lirimi i plote i brezit 700 MHz (DD2) që fillon nga frekuenca 694 – 790 MHz. Bazë: 0% e brezit të liruar në momentin e fillimit të procesit. Objektiv: 100% e brezit të liruar brenda 6 muajve.
5. Përfundimi i procedurave institucionale për kalimin e administrimit të brezit 700 MHz te AKEP dhe vënia e tij në dispozicion për autorizimin e përdorimit nga rrjetet 5G. Bazë: brezi nuk është ende vënë në dispozicion të AKEP për këtë qëllim. Objektiv: përfundimi i kalimit administrativ dhe krijimi i kushteve për dhënien në përdorim të frekuencave brenda një afati të përcaktuar.;

**Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a**

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

| | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Viti 6 | Viti 7 | Viti 8 | Viti 9 | Viti 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Faktori zbritës** | | | | | | | | | | | |
| Kosto për buxhetin – një herë | | 3.216 ml € | 3.216 ml € | | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për buxhetin – në vazhdim | | | | | | | | | | | |
| Kosto për biznesin – një herë | | | | | | | | | | | |
| Kosto për biznesin – në vazhdim | | | | | | | | | | | |
| Kosto për grupet e tjera – një herë | | | | | | | | | | | |
| Kosto për grupet e tjera – në vazhdim | | | | | | | | | | | |
| **Kosto në total** | | 3.216 ml € | 3.216 ml € | | | | | | | | |
| **Kosto e zbritur në total** = Kosto në total x faktorin zbritës | | | | | | | | | | | |
| Përfitimi për buxhetin – në vazhdim | | | | | | | | | | | |
| Përfitimi për biznesin – një herë | | | | | | | | | | | |
| Përfitimi për biznesin – në vazhdim | | | | | | | | | | | |
| Përfitimi për grupet e tjera – njëherë | | | | | | | | | | | |
| Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kosto për buxhetin – në vazhdim | | | | | | | | | | | |
| **Përfitimi në total** | | | | | | | | | | | |
| **Përfitimi i zbritur në total** = Përfitimi në total x faktorin zbritës | | | | | | | | | | | |
| **Vlera aktuale e kostos në total** | | | | | | | | | | | |
| **Vlera aktuale e përfitimit në total** | | | | | | | | | | | |
| **Vlera aktuale neto (VAN) =** Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total | | | | | | | | | | | |

**Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b**

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

| **Opsioni** | **Vlera aktuale në milionë lekë** | | **Vlera aktuale neto në milionë lekë** |
|---|---|---|---|
| | **Kosto** | **Përfitimi** | |
| Opsioni 1 | **6,432,500 Euro** | Nuk mund ta përllogarisim në këtë moment | |
| Opsioni 2 | | | |